



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 03.10.2025
Numër Protokolli: 6557/2025

A.nr.1546/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës– Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj Demi, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurën sipas ankesës me numër A.nr.1546/2025, të datës 06.08.2025, të parashtruar nga ankuesi L.H, nga Prishtina, kundër Inspektoratit të Punës, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 03.10.2025, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i iniciuar sipas ankesës A.nr.1546/2025 e datës 06.08.2025, të parashtruar nga ankuesi L.H.

A r s y e t i m

Kandidati për pranim në shërbimin civil L.H (*në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi*), më datë 06.08.2025, ka parashtruar ankesë Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar nën shenjën A.nr.1546/2025, kundër procedurës së pranimit sipas konkursit me Nr. Reference: RN00017340, Grupi Administrim i Përgjithshëm, pozita e punës Inspektor për Siguri dhe Shëndet në Punës në Divizionin për Inspektim në Rajonin Prishtina 1, i shpallur nga Inspektoratit i Punës, për shkak të shkeljeve të rënda procedurale dhe ligjore.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 13.08.2025, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Inspektorati i Punës, ndërsa, ky i fundit, më datë 10.09.2025 ka përcjellë shkresat referuar çështjes në procedurë.

Kolegji i Këshillit, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruar nga palët në procedurë, ka konstatuar se janë plotësuar parakushtet ligjore që të ***përfundoj procedimi administrativ*** i filluara me ankesën e ankuesit, **sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se Inspektorati i Punës më datë 21.03.2025, ka shpallur konkursin me Nr. Reference: RN00017340, Grupi Administrim i Përgjithshëm, pozita e punës Inspektor për Siguri dhe Shëndet në Punë në Divizionin për Inspektim në Rajonin Prishtina 1, numri i kërkuar nëntë (9), klasa profesional 1.

Tutje sipas provave të lëndës, rezulton se ankuesi ka aplikuar në këtë konkurs, dhe sipas njoftimi për fazën e verifikimit paraprak i njëjti rezulton se ka kaluar fazën e verifikimit paraprak për të marr pjesë në fazën e vlerësimit profesional, ndërsa pas përfundimit të procesit, rezulton se lidhur me konkursin me Nr. Reference: RN00017340, Divizioni për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Inspektoratin e Punës më datë 10.07.2025 e ka publikuar njoftimin për rezultatet përfundimtare me 18 kandidat që kanë marr mbi 70 pikë, ku rezulton se ankuesi nuk ka arritur të marr 70 pikë, respektivisht nuk rezulton të jetë kandidatë i suksesshëm.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër kësaj procedure të rekrutimit, pretendon se ka pasur shkelje të rënda procedurale dhe ligjore, duke kërkuar që konkursi të anulohet dhe të rishpallet i njejt.

Kolegji i Këshillit duke marrë përbazë numrin e lëndëve në shqyrtim, ka konstatuar se për të njëjtin konkurs lidhur me kontestimin e procedurave të rekrutimit, me datë 15.07.2025 Këshilli ka pranuar ankesë nga ankuesi N.G, kandidatë në procedurë të rekrutimit, ndërsa me datë 01.10.2025 Këshilli ka nxjerrë Vendimin A.nr.1573/2025 përmes së cilit është aprovuara ankesa e ankuesit N.G, ndërsa është ***anuluar*** në tërësi konkursi me Nr. Reference: RN00017340, Grupi Administrim i Përgjithshëm, pozita e punës Inspektor për Siguri dhe Shëndet në Punës në Divizionin për Inspektim në Rajonin Prishtina 1, procedurë të rekrutimit të cilën e konteston edhe ankuesi në këtë çështje administrative.

Nisur nga rrethanat e paraqitura si më lartë, Kolegji i Këshillit mori për bazë dispozitat e nenit 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: *“Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kotë”*, dhe mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit konstatoi se janë plotësuar kushtet ligjore që të përfundohet procedimi administrativ lidhur me ankesën e ankuesit A.nr.1546/2025 të datës 06.08.2025 pasi që objekti i shqyrtimit të kësaj lëndës është bërë i pamundur apo i kotë, ngase përmes Vendimit A.nr.1573/2025 të datës 01.10.2025 Këshilli ka vendosur lidhur me këtë procedurë të rekrutimit sipas konkursit më shifër reference: RN00017340, Grupi Administrim i Përgjithshëm, pozita e punës Inspektor për Siguri dhe Shëndet në Punës në Divizionin për Inspektim në Rajonin Prishtina 1, me që rast e ka anuluar të njëjtin.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nën 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 si dhe nën 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe nën 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr1546/2025, datë 03/10/2025

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit L.H;
- Inspektoratit të Punës (*Njësisë së Burimeve Njerëzore*), si dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.